



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6381 /2026
Data: 20.07.2026

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e gjashtë -VI-për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 24.06.2026 me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Nënkryetarin e Komunës.
3. Takim me përfaqësuesin e Hendikos në Han të Elezit.
4. Takim me Drejtorinë e Arsimit.
5. Eventuale.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Nënkryetarin e Komunës.

Kryesuesi thekson: Fillimisht ju përgëzoj për punën të cilën e keni bërë edhe gjatë mandatit të kaluar dhe tash që jeni duke e bërë, për shkak se disa projekte që i kemi marrë si komunë janë duke ju falënderuar punës suaj që e keni bërë, që do të thotë gjithmonë keni qenë aktivë, sidomos në Qeveri, që keni bërë punë të mëdha që qytetarët e Hanit të Elezit sot i gëzojnë. Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: Unë do t'ju njoftoj për punët të cilat do të realizohen në të ardhmen dhe që është projekti i ujit të pijes, që është në bashkëpunim me kompaninë Bifurkacioni. Duhet të dihet që kjo është kompetencë e Bifurkacionit, por obligohemi si komunë të gjejmë investime dhe, si kërkesë e Bifurkacionit, është ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Han të Elezit. Kanë filluar me disa punime, por fatkeqësisht as procedurat e prokurimit e as të menaxhimit nuk i kemi ne si komunë, por i ka Bifurkacioni, që na ka nxjerrë shumë shqetësime, për shkak se kompania e cila e ka marrë tenderin është dashur edhe asfaltin ta rregullojë, por kjo i ka mbetur komunës. Është një fat i mirë që në vitin 2025 e kam dërguar një projekt te Katari për ta rregulluar komplet rrjetin e ujësjellësit në Han të Elezit dhe javën e kaluar ma kanë konfirmuar që jemi fitues të atij projekti. Pra, do të ndërrohet rrjeti prej marketit Besa e deri te stacioni i trenit, që do të përfshihet prej udhëkryqit para komunës e deri te ndërtesa e Lurit. Sipas informatave që i kam prej Drejtorisë për Shërbime Publike, prej udhëkryqit e deri te shkolla e mesme diku tridhjetë kyçe ilegale kanë qenë, pra ka shumë humbje të ujit dhe nuk po mundet të menaxhohet. Tash e kam kërkuar që, në momentin që të hapet kanali, të rregullohet në mënyrë që të mos mbetet keq.

Kryesuesi thekson: Është ndërruar gypi deri te shkolla e mesme, por në Kornizën Afatmesme Buxhetore e pashe që në vitin 2027 ishte planifikuar të bëhet asfaltimi, që do të thotë se në këtë vit nuk ka mundësi.

Sevdi Dernjani thekson: Të mbeten gropat për një vit për ne si komunë është e papranueshme, sepse janë edhe shqetësimet e bizneseve edhe të qytetarëve. Ne nuk e kemi pasur në procedurë, për shkak se nëse dëmtohet rruga duhet të rregullohet, por këto procedura i ka udhëhequr Bifurkacioni, por shpeshherë me procedurat e tyre ne po e marrim barrën, siç e dini edhe ju. Në pjesën tjetër që do të bëhet ndërrimi i gypit, është në procedurë edhe asfaltimi i rrugës në momentin që do të përfundojë ndërrimi i gypit. Ka filluar edhe faza e dytë e projektit të shtrimit të rrugës Gorancë-Krivenik, ndërsa në proces e sipër jemi te parku te pishat. Kemi pasur probleme në procedurat e prokurimit dhe kemi lidhur kontratë me Komunën e Ferizajt, e cila është duke na ndihmuar për procedurat e prokurimit. Do të lidhet kontrata për rregullimin e ndriçimit publik, ndërsa për të rregulluar një pjesë të ndriçimit janë përfunduar procedurat e prokurimit dhe shumë shpejt do të bëhet rregullimi i ndriçimit. Për ditën e premte ma ka konfirmuar takimin shefi i kabinetit në Ministrinë e Shëndetësisë, ku kërkesë kam pasur për të ndërtuar një QKMF të re komplet.

Sead Vila thekson: Gjatë kryerjes së punimeve për ndërrimin e gypit të ujësjellësit në rrugën që shkon deri te shkolla e mesme, ankesë kam pasur që kompania gjatë kryerjes së punimeve nuk ka pasur masa mbrojtëse dhe është mirë që kompanisë Bifurkacioni t'i rekomandohet që, derisa janë duke kryer punimet, t'i vendosin edhe masat mbrojtëse. Po ashtu, edhe qytetarët është dashur të njoftohen për ndërprerjet e ujit. Kërkesë kam pasur edhe nga banorët e lagjes Imri Curri, ajo pjesë e cila kthen në fund të rrugës për t'u lidhur me nënkalimin, pra është si lloj unaze, dhe është mirë që të bëhet pak më e drejtë. Po ashtu, duhet të shikohen mundësitë që të nivelizohet me asfalt.

Sevdi Dernjani thekson: Sa i përket punës së punëkryesit për ndërrimin e gypit të ujës-jellësit, unë vetë gjatë diskutimit i shpreha pakënaqësitë e mia ndaj kompanisë, e cila nuk është një kompani serioze dhe nuk ka operuar në bazë të kriterëve që ne, të paktën, i kemi rekomanduar. Fatkeqësia e kësaj është që po duhet të dal dhe të jap rekomandime, por as procedurat e prokurimit nuk i kemi zhvilluar ne, sepse ne kishim mundur të vendosnim kriterë më të forta, por fatkeqësisht ka ardhur kjo kompani dhe ka hasur probleme kudo që ka shkuar. Pra, i kemi këto shqetësime për këtë kompani. Sa i përket asaj unaze të rrugës që potencove, unë për herë të parë jam duke dëgjuar, ndërsa çështjen e gropave të asfaltit do ta shikohen mundësitë buxhetore, por është mirë të propozohen në dëgjimet buxhetore për të hyrë si kod buxhetor.

Erbilin Meliqi thekson: Te parku te pishat, rrjeti elektrik a do të bëhet me panel solar apo do të vendosen shtyllat elektrike? Tregu a do të bëhet brenda vitit 2026 apo do të kalojë për vitin 2027?

Sevdi Dernjani thekson: Sipas informacioneve që i kam, rryma do të shkojë me shtylla elektrike prej fshatit Gorancë ose prej kompanisë Akro. Sa i përket tregut, e kemi diskutuar me drejtorin e Urbanizmit dhe mundësitë janë që të mos bëhet, sepse nëse bëhet sheshi para komunës, si alternativë ka me ardhur rruga prej asaj pjesës andej, në mënyrë që të kenë hyrje edhe banorët e asaj pjese.

Ibadete Kuka thekson: Te parku te pishat, si do të rregullohet çështja e ujit?

Sevdi Dernjani thekson: Do të rregullohet një bunar përmes shpimit.

Valmira Bushi thekson: Përveç ndriçimit publik që duhet të rregullohet, është mirë që edhe shtyllat elektrike të rregullohen.

Sevdi Dernjani thekson: Adresa e parë e gjithë qytetarëve është komuna, mirëpo me shtyllat elektrike merret KEDS-i, pra ata janë përgjegjës. Unë personalisht kam dërguar email dhe u kam thënë që duhet të merren me këtë çështje.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.

3. Takim me përfaqësuesin e Hendikos në Han të Elezit.

Kryesuesi thekson: Pasi që përfaqësuesit e Hendikos nuk janë prezentë, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.

4. Takim me Drejtorinë e Arsimit.

Kryesuesi thekson: Sa i përket kontratës kolektive, komuna ka bërë pajtim që çdo lëndë që vjen prej gjykatës të kryhet, të mos shkojë në përmbarues. Unë u njoftova që janë disa lëndë që janë kryer në gjykatë dhe tash janë në komunë.

Sevdi Dernjani thekson: Nuk kemi mjete financiare të mjaftueshme dhe e kemi pritur rialokimin e mjeteve që të mundemi t'i kryejmë disa pagesa, por drejtoresha për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e bordit ka potencuar që kushdo që ka obligime, t'i paraqesë që të mund t'i kryejmë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.

5. Eventuale

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hap diskutimin.

Sead Vila thekson: Pasi jemi në sezonën e verës, ka probleme të shumta, por gjatë muajit korrik dhe gusht është gjallëria më e madhe dhe besoj që policia e ka në plan sigurinë. Është mirë që në mbledhje të KKS-së të sugjerohet që policia të jetë më shumë në terren dhe më afër qytetarëve, për shkak se po ka frekuentim me motorë dhe zhurmë.

Sevdi Dernjani thekson: Në mbledhjet e KKS-së, të cilat mbahen vazhdimisht, ne i rekomandojmë këto çështje, por do ta paraqes shqetësimin të cilin e parashtrova.

Kryesuesi thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 15:00.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Komitetit
Basri Dernjani

